

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Thaçi dhe Krasniqi dënohen me nga 25 vjet burgim, Veseli me 18 dhe Selimi me 13 vjet
ADRESA	https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/thaci-dhe-krasniqi-denohen-me-nga-25-vjet-burgim-veseli-me-18-dhe-selimi-me-13-vjet
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 02:17:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:06:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f5989c3ec8560d609b39db575c1fb35cae5c21a31348b465fa00bda1be06ad0c
TEKSTI	e188fe772dbef0076142943171a04147c5021302202e2fe94e339f4549cbd13
PAMJA	ce72dfffa4e506cc11db6d3c8eeaec5f18d748878ec2b4c684103c513ef214794

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e9c22a0a45b182ccaea5310f1680eab9ac112eb271bcf6b0452718a17ec9fe1a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	620a3e0ea5360256664d4fe0b9b06d4faf85ac171f0ef56a543d5c170249f92b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e9c22a0a45b182ccaea5310f1680eab9ac112eb271bcf6b0452718a17ec9fe1a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LAJMET E MBRËMJES

Thaçi dhe Krasniqi dënohen me nga 25 vjet burgim, Veseli me 18 dhe Selimi me 13 vjet



Nga: Blendina Veliqi

16 shtator 2026 19:06

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përgjeshura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Verdikt dënues ka shqiptuar shkalla e parë e Gjykatës Speciale ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit. Ndonëse trupi gjykues rrëzoi akuzat për krime kundër njerëzimit, ai i bëri përgjegjës për një numër krimesh të luftës. Thaçi e Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, Veseli me 18 e Selimi me 13.

Gjykata Speciale ka dënuar të katër ish-udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me dënimin në total prej 81 vjetësh burgim.

Ndonëse trupi gjykues rrëzoi akuzat për krime kundër njerëzimit, ai i bëri përgjegjës për krime lufte Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin e Rexhep Selimin.

Gjykatësit konstatuan se ata dhanë kontribut të qenësishëm në zbatimin e, siç e kanë quajtur, qëllimit kriminal të përbashkët të shënjestrimit të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë të qëllimeve politike dhe ushtarake të UÇK-së.

“Katër të akuzuarit dhe personat e tjerë në udhëheqjen e UÇK-së përfshirë edhe ata që pretendohet se janë anëtarë të NPK-së kishin dy objektiva: Pavarësinë e Kosovës dhe vendosjen e kontrollit politik dhe institucional mbi atë që shprejonin se do ta kishte një Kosovë e pavarur”, tha kryetari i Trupit Gjykues Charles Smith.

Trupi Gjykues konstatoi se të katër të akuzuarit janë penalisht përgjegjës për krimet e luftës të ndalimit arbitrar ndaj 385 personave, trajtimit mizor ndaj 49 personave, torturës ndaj 303 personave dhe vrasjes së paligjshme ndaj 96 personave.

Edhe



Arbëri • 4 o. më parë

81 vjet burgim për katër ish-drejtnesit e UÇK-së

Arbëri.

81 vjet burgim për katër ish-drejtnesit e UÇK-së

Arbëri.

Qytetarët sërish mbledhen para EULEX-it, e gjuajnë me gurë e mjete piroteknike

Arbëri.

Dy protestues u shoqëruan në polici, njëri u ndalua për 48 orë

Kronikë.

Vdiq një 21-vjeçar, u godit nga vetura në fshatin Vlashnje

Futboll.

Humbje për Milanin në Ligën e Evropës

Futboll.

Tjetër goditje për Manchester Unitedin

Dënimet më të mëdha u shqiptuan ndaj Thaçit e Krasniqit.

“Z. Thaçi, në emër të popullit të Kosovës... Trupi gjykues ju dënon me një burgim të njehsuar me 25 vjet burgim ... Trupi gjykues... ju shpall ju, Jakup Krasniqi fajtor... Trupi gjykues ju dënon me një dënim të njehsuar me 25 vjet burgim”, tha Smith.

Për vepra të ngjashme, u dënuan me burgim edhe Veseli e Selimi.

“Z. Veseli në emër të popullit të Kosovës... trupi gjykues... ju shpall ju, Kadri Veseli fajtor... Trupi gjykues ju dënon me një burgim të njehsuar me 18 vjet burgim ... Trupi gjykues... ju shpall ju, Rexhep Selimin fajtor... trupi gjykues ju dënon me dënim të njehsuar me 13 vjet burgim”, tha Smith.

Prokuroria pati kërkuar dënim me nga 45 vjet burgim për Thaçin, Krasniqin, Veselin e Selimin, të cilët i pati akuzuar edhe për krime kundër njerëzimit. Por, sipas trupit gjykues organi i akuzës nuk ka mundur ta vërtetojë këtë.

“Lidhur me ekzistencën e një sulmi të përhapur kundër popullatës civile si kusht për krim kundër njerëzimit trupi gjykues konstatoi se ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë jashtë dyshimit të arsyeshëm se ishte kryer ky sulm i përhapur gjerësisht kundër popullatës civile”, deklaroi Smith.

Edhe



Arbëri • 16 o. më parë

Publikohet përmbledhja e aktgjykimit të dënimit të Thaçit dhe të tjerëve

Dënimin për krime lufte, Trupi gjykues e ka arsyetuar duke konstatuar se midis prillit 1998 dhe qershorit 1999, së paku 385 personave iu hoq arbitrarisht liria dhe 96 u vranë.

Kryetari i trupit gjykues tha se ishin shqiptarë të Kosovës që kishin lidhje me forca politike ose ushtarake të tjera, si LDK-ja dhe FARK-u; persona që pretendohesh se kishin lidhje me autoritetet e Serbisë, dhe anëtarë të caktuar të pakicave të tjera etnike, përfshirë romë dhe serbë.

“Ata ranë në marrëveshje për qëllimin e përbashkët kriminal, bashkërisht vendosin një sistem për realizimin e tij, ngritën objekte ndalimi, krijuan dhe përcaktuan rregulla për policinë ushtarake, shërbimin e zbulimit dhe njësitë speciale dhe u dhanë detyrën për përbushjen e planit kriminal të tyre... lëshuan komunikata që përhapën mendime të tyre, sulmuan armiq dhe morën përgjegjësinë për vrasjet dhe ndalimet e paligjshme bashkërisht”, tha Smith.

Trupi gjykues i fatoi Thaçit edhe përgjegjësi për pjesëmarrje në krime.

“Thaçi mori pjesë personalisht në krime, përfshirë arrestimin, ndalimin dhe martjen në pyetje të 13 parlamentarëve në Qirez dhe Baicë, si dhe në arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e paligjshme të Behajdin Hallaqit”, theksoi Smith.

Sipas trupit gjykues, një numër personash të tjerë si Lahi Brahimaj, Fatmir Limaj, Sylejman Selimi, Rustem Mustafa, Latif Gashi, Shukri Buja dhe Sabit Geci, kishin dhe ranë në marrëveshje për qëllimin kriminal të përbashkët dhe morën pjesë në realizimin e tij, por se në lidhje me ta nuk u bë konstatim fajësie.

Edhe



Arbëri • 20 o. më parë

Thaçi e Krasniqi dënohen me nga 25 vjet burgim, Veseli 18 e Selimi 13

Procesi kryesor në Hagë nisi në nëntor të 2020-s kur katërshja e UÇK-së u arrestua nga policia ndërkombëtare dhe u transferua në Hagë. Ata ndodhen prej pothuajse gjashtë vjetësh në paraburgim.

Verdikti i Themelores nuk është përfundimtar dhe mbrojtja ka paralajmëruar apelim.

#HASHIM THACI

#KADRI VESELI

#JAKUP KRASNIQI

#REXHEP SELIMI

Artikuj të ngjashëm



Arbëri • 7 o. më parë

**Zeqiri për aktgjykimin e Speciales:
Vendim brutal, u dënua Pavarësia e
Kosovës**

Arbëri • 8 o. më parë

**Liderë shtetërorë e politikë thonë se e
vërteta e luftës në Kosovë është ndryshe
nga vendimi**

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohej kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësitve që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkohësi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh
Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.